

Korrigjim: asnjë azilkërkuesi nuk i ka mbaruar e drejta për punë më 1.6.2019 vetëm për shkak se ligji i ri ka hyrë në fuqi

E drejta e azilkërkuesit për punë ndryshoi më 1.6.2019 me rastin e ndryshimit të Ligjit për të huajt. Ndryshimi i ligjit ka qenë i ndërlikuar: interpretimi i ligjit ka qenë sfidues dhe lidhur me këtë jemi detyruar të bisedojmë më shumë se zakonisht, brenda Drejtorisë si dhe me Ministrinë e punëve të brendshme. I kemi larguar nga faqet tona të internetit kumtesat e vjetra, me qëllim që informacionet që kanë qenë në to të mos i ndërlikojnë e dhe më shumë klientët dhe punëdhënësit.

Asnjë azilkërkuesi nuk i ka mbaruar e drejta për punë më 1.6.2019 vetëm për atë arsye se ligji i ri ka hyrë në fuqi.

Na vjen keq sinqerisht që nuk kemi arritur t'ju informojmë për këtë çështje mjaft qartë dhe me kohë.

E drejta për punë duke filluar nga 1.6.2019

Kërkuesit që e kanë bërë kërkesën për azil para 1.6.2019:

- Nëse ti ke pasur të drejtën për punë më 31.5.2019, ajo ka vazhduar dhe vazhdon deri atëherë, kur të jepet vendimi i implementueshëm për t'u larguar nga shteti, pra kur sipas ligjit ty mund të [të largojmë nga Finlanda](#).
- Nëse ti ke pasur të drejtën për punë më 31.5. dhe para 1.6. të ka ardhur vendim i implementueshëm për t'u larguar nga shteti, e drejta jote për punë mbaron atëherë, kur vendimi bëhet [i plotfuqishëm](#).
- Nëse nuk ke pasur të drejtë pune më 31.5., e drejta jote për të punuar fillon 3 muaj pas bërjes së kërkesës nëse ti ke një dokument udhëtimi me afat valid kurse pas 6 muajsh nëse ti nuk ke një dokument valid të udhëtimit.
- E drejta për punë mbaron atëherë, nëse ti fiton lejen e qëndrimit në ndonjë bazë. Pas kësaj e drejta jote eventuale për punë bazohet në atë leje të qëndrimit.

Kërkuesit që e kanë bërë kërkesën për azil më ose pas 1.6.2019/1.6.2019:

- E drejta jote për punë fillon pas 3 muajsh pas bërjes së kërkesës nëse ti ke një dokument udhëtimi me afat valid, kurse pas 6 muajsh nëse ti nuk ke një dokument valid të udhëtimit.
- Nëse ti e përsërit kërkesën për azil, afatet fillojnë prej fillimit, d.m.th. e drejta për punë ndërpritet për 3 ose për 6 muaj.
- E drejta jote për punë mbaron kur vendimi për të të larguar nga Finlanda është i implementueshëm, pra kur sipas ligjit ty mund [të largojmë nga Finlanda](#).
- E drejta për punë mbaron atëherë, nëse ti fiton lejen e qëndrimit në ndonjë bazë. Pas kësaj e drejta jote eventuale për punë bazohet në atë leje të qëndrimit.

Nga mund të marrin kërkuesi dhe punëdhënësi informacione rreth të drejtës për punë?

Azilkërkuesi:



- Nëse të jepet vendim pozitiv, informacioni rreth të drejtës për punë shkruan në vendim dhe në kartelën e lejes së qëndrimit.
- Nëse të jepet vendim negativ, informacioni mbi përfundimin e të drejtës për punë shkruan në vendim.
- Vendimi të bëhet me dije në gjuhë amtare ose në gjuhën që e kupton. Në rast nevoje, gjatë bërjes me dije përdorim ndihmën e interpretit ose përkthyesit.
- Nëse nuk të është dhënë vendimi ende, punëdhënësi njëherë-për-njëherë mund të pyes rreth të drejtës tënde për punë [nëpërmjet telefonit](#) në ora 9–12. Nëse të ka ardhur vendim pozitiv, tregojta punëdhënësit të drejtën tënde për punë me anë të kartës së lejes së qëndrimit.

Punëdhënësi:

- Rreth të drejtës për punë të azilkërkuesit mund të pyesësh njëherë-për-njëherë [nëpërmjet telefonit](#) në ora 9–12.